



## In medias res

### Qëllimi moral i ndryshimeve në arsim

Ndryshimet në arsim janë procese të pandalshme. Ato ndodhin sipas inercionit dhe spontanitetit. Ato mund të jenë të rastësishme, por edhe të planifikuara dhe të programuara. Si do që të jetë ato janë të kushtëzuara, që do të thotë i nënshtrohen ligjit të kauzalitetit. Ndryshimet e paplanifikuara zakonisht nuk sjellin progres, përparime, zhvillime dhe prosperitet. Ndryshimet e planifikuara dhe të programuara janë ndryshimet me të cilat synohet avancimet e sistemit arsimor. Nga ky avancim duhet të përfitojnë nxënësit, studentët, familjet dhe tërë shoqëria. Në të gjitha vendet në të cilat ndryshimet që ndodhin nuk bëhen avancime dhe përparime nga të cilat do të përfitojnë qytetarët e atij vendit janë ndryshime retrograde sepse këto ndryshime nuk sjellin përfitime për qytetarët e vendit. Qëllimi moral i ndryshimeve në arsim është në të vërtetë përfitimi i qytetarëve që ata kanë nga ndryshimet në arsim, përfitim i cili lidhet me zhvillimin tyre të plotë që në instancën fundit manifestohet në mirëqenie, drejtësi, barazi, jetëgjatësi, shëndet të plotë, kohezion shoqëror dhe mjedis miqësor për njeriun. Të gjitha ndryshimet të cilat nuk e kanë të përcaktuar qartë qëllimin moral, vështirë jetësohen, sepse ato nuk shndërrohen në pronësi të qytetarëve

Ndryshimet me qëllime morale të përcaktuara janë ndryshime pozitive sepse janë të orientuara në zhvillimin dhe vet-aktualizimit e qytetarëve.

Ndryshimet në arsim pa qëllime të përcaktuara dhe mirë të piketuara të cilat nuk shprehin nevojat reale të qytetarëve që nuk janë në funksion të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror-ekonomik, teknik, teknologjik dhe shëndetësor të qytetarëve quhen ndryshime retrograde – negative, sepse ato në vend se të ndihmojnë daljen nga kriza, varfëria, mjerimi dhe degradimi moral, ato thellojnë akoma më shumë krizën, edhe më tepër degradojnë moralin dhe etosin si të institucioneve arsimore ashtu dhe të qytetarëve. Reforma të këtilla nuk janë të rralla në shtetet në tranzicion, në vendet me demokraci të pazhvilluar dhe me qeverisje autokratike, kleptokratike, oligarkike etj.

Ndryshimet e proklamuar në këto vende kanë funksion propagandues dhe mashtrues. Ato zakonisht nuk përcillen me analiza, për të nuk ka dokumente të bazuar në shkencë nuk ka analiza të thelluara të nevojave që qytetarëve, janë pa vizione zhvillimore, pa misionë adekuate të përcaktuara, pa objektiva përkatëse paraprake zhvillimore, pa bartës dhe përgjegjës të përcaktuar. Reformat e këtilla zakonisht fillohen nga lartë duke emërtuar formalisht grupe të ekspertëve në mesin e të cilëve mund të ndodh të mos ketë ka asnjë ekspertë. Këto ndryshime të projektuara mbeten të mbyllura në grupe të ngushta, për të nuk zhvillohet debat i mirëfilltë, mjetet e informacionit shërbejnë vetëm si kanale informacioni, pa qasje kritike kështu që nuk krijojnë “presion” mbi agjentët e ndryshimit. Andaj edhe për dështimet të cilat më vërtetohen, askush nuk jep llogaridhënie. Në mjedise nuk krijohet një mendësi e re për nevoja të ndryshimeve. Debatet për ndryshime ose nuk realizohen fare ose realizohen në mënyrë formale. Për të krijuar një opinion pozitiv (për të mashtruar) kompetentët flasin dhe shkruajnë për reforma të suksesshme në mënyrë që të fitohet përshtypja se qeveria, dikasteret e caktuar të ministrisë po bëjnë punë të madhe. Ndryshimet e këtilla, për shkak të improvizimeve, mospjesëmarrjes së të gjithë agjentëve në ndryshime (mësimdhënësve, udhëheqësve të arsimim, të prindërve, të nxënësve dhe të studentëve) janë të dënua të dështojnë, siç edhe kanë dështuar deri më tani

*Shkroi: Halim Hyseni*

## Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSh

■ Gjatë muajit janar është bërë monitorimi i 220 mësimdhënësve të komunave Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë, të cilët janë duke vijuar trajnimin e MKLSh-së. Pas përfundimit të monitorimit në këto qendra janë mbajtur takimet gjysmë-ditore më datën 31 janar. Nga fletë monitorimet dhe raportet e takimeve gjysmë-ditore vërehet se trajnerët janë të kënaqur me përkushtimin e mësimdhënësve për të implementuar teknikat e mësuara në kuadër të programit të MKLSh-së. Trajnerët kanë evidentuar se mësimdhënësit në të shumtën e rasteve kanë organizuar orën sipas strukturës ERR, kanë përdorë teknika të përshtatshme për njësinë mësimore dhe nivelin psiko-fizik të nxënësve, si dhe kanë arritur të angazhojnë nxënësit për punë në grupe gjatë orës mësimore. Njëra nga pikat e dobëta që është evidencuar nga trajnerët është fakti se mësimdhënësit kanë problem në caktimin e kohës për implementimin e teknikave dhe se shpesh formalizmi mbizotëron mbi përgjegjësinë për realizimin e objektivave mësimore. Të gjithë mësimdhënësit u informuan se seminari i 4 do të mbahet më 7-8 shkurt 2009.

■ Më 17-18 janar si dhe 31 janar e 1-shkurt janë mbajtur seminari i tretë dhe i katërt për mësimdhënësit e komunës së Podujevës. Ky trajnim vetë financohet nga pjesëmarrësit dhe nga raportet e trajnerëve shihet se çdo gjë është duke shkuar sipas agjendës së përgatitur nga KEC. Të 36 mësimdhënësit që vijojnë këtë trajnim do të monitorohen gjatë muajit shkurt.

## Hap pas Hapi

■ Në Prishtinë, në lokalet e KEC u mbajt trajnimi avancues për edukatorët të cilat punojnë me fëmijët e grupmoshave 3-6 vjeç. Ky trajnim u mbajt në datat 19-24 janar. Në trajnim morën pjesë 20 edukatore të institucioneve parashkollore të Prishtinës.



■ Në Pejë u organizuan tre trajnime për klasën e dytë. Trajnimet u mbajtën me këto data:

Grupi I 20, 21 dhe 27 dhjetor 2008


Grupi II 28 janar 2008, 10, 11 janar 2009

Grupi III 17, 18, 24, janar 2009

Nga të tre grupet u certifikuan 72 mësues, të cilët gjatë këtij viti do të punojnë me klasën e dytë.

## Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Në kuadër të këtij projekti gjatë muajit janar është përgatitur dhe botuar FLETA INFORMATIVE, publikim ky ku janë pasqyruar aktivitetet e këtij projekti. Gjithashtu, është bërë identifikimi i tri komunave në të cilat do të zhvillohen tryezat e rrumbullakëta.



Është krijuar koncepti për punën e komiteteve rajonale, është duke u përgatitur një raport i detajuar për gjendjen e të drejtave të fëmijës nga këndi i një vlerësimi të shpejtë.

## **Trajnimi i mësimdhënësve të arsimit parauniversitar sipas programit edukimi multikulturor**

■ Ky projekt realizohet në bashkëpunim me Shoqatën Arsimimi i të Rriturve në Kosovë- ARrK (DVV International). Zbatimi i këtij projekti ka filluar në muajin dhjetor, 2008. Do të zgjas deri me 28 shkurt 2009. Në projekt është paraparë trajnimi i 25 – 30 mësimdhënësve të arsimit parauniversitar për edukimin multikulturor. Gjatë muajit janar është përgatitur programi i trajnimit, është përgatitur Manuali për mësimdhënës, është bërë përzgjedhja e mësimdhënësve. Trajnimi pesëditore do të zhvillohet gjatë muajit shkurt 2009.

## **Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II**

■ Këshilli për Aprovimin e Granteve Shkollore (KAGSh) mbajti mbledhjen e vet me 14 janar 2009. Në këtë mbledhje u shqyrtuan projektet e shkollave pjesëmarrëse në ciklin shtesë të PPPA II. Të gjitha projektet shkollore u aprovuan. Pritet që së shpejti të lidhen kontratat për grante në mes të shkollave përfituese, DKA dhe Ekipit koordinues të Projektit.

Përfaqësuesit e shkollave të ciklit shtesë të projektit morën pjesë në një trajnimet gjysmëditore nëpër rajone që u organizuan nga KEC. Këto trajnime kishin për qëllim njohjen e përfaqësuesve të shkollave me procedurat e prokurimit dhe financave nën Projektin për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim II. Konsiderohet se shkollat janë të gatshme për realizimin e projekteve shkollore, ndërsa gjatë realizimit do të këshillohen dhe monitorohen nga stafi i EKP.

Ndryshe, më 31 janar përfundoi angazhimi i KEC-it në Projektin për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (PPPA), i cili kishte për qëllim rritjen e vijueshmërisë në shkolla dhe zvogëlimin e braktisjes. Ky projekt realizohet me ndërprerje të vogla, prej shtatorit të vitit 2002 dhe, gjatë kësaj kohe mbi 600 shkolla fillore dhe të mesme të Kosovës kanë përfituar grante për financimin e projekteve shkollore me qëllim të përmirësimin të vijueshmërisë dhe zvogëlimin të braktisjes. Implementues i projektit ishte Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, ndërsa financimi u siguroi nga granti i Bankës Botërore. Roli i KEC-it ka qenë t'iu ofrojë përkrahje shkollave në hartimin e planeve zhvillimore të tyre dhe të propozimeve për financim, si dhe t'i ndihmojë MASHT-it në kryerjen e procedurave administrative, përfshirë ato të prokurimit dhe financiare, në nivel të shkollës dhe të komunës.

## **Ndërtim kapaciteti për pjesëmarrje në bashkëpunim shkencor**

■ Më 14-15 janar, tre ekspertë nga fusha e bujqësisë, prof. dr. Ademaj Demaj, prof.dr. Skender Kaçiu dhe mr. Arben Mehmeti morën pjesë në një konsultim rajonal për prioritetet shkencore në fushën e prodhimit të ushqimit. Konsultimi u mbajt në Podgoricë, ndërsa pjesëmarrës ishin ekspertët e lëmisë nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

■ Më 30 janar KEC, në bashkëpunim me Qendrën e Kosovës për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Arsim të Lartë, Shkencë dhe Teknologji, organizoi një trajnim për aspektet financiare të Programit FP7 të Komisionit Evropian. Në trajnim morën pjesë punonjës shkencorë dhe administratorë të interesuar për Programin FP7 i cili është një ndër burimet kryesore për financimin e punës kërkimore-shkencore në Evropë, ndërsa trajnimi u drejtua nga dr. Albena Vutsova dhe zonja Lora Pavlova, eksperte nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të Bullgarisë.



Të dy aktivitetet u zhvilluan në kuadër të projektit WBC-INCO.net, i cili financohet nga programi FP7, e ku KEC është një ndër 26 organizatat partnere. Ky projekt ka për qëllim promovimin e dialogut rajonal në fushën e shkencës dhe teknologjisë, identifikimin e potencialeve dhe prioriteteve shkencore, si dhe shtimin e pjesëmarrjes së hulumtuesve nga Ballkani Perëndimor në projekte evropiane.

## **Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim**

■ Në kuadër të projektit “Monitorimi i Implementimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve RAE në

Arsim”, këtë muaj janë zhvilluar aktivitetet e fundit të projektit. Aktiviteti i parë i zhvilluar gjatë këtij muaji ishte organizimi i Tryezës së rrumbullakët në Gjakovë me temë: “Integrimi i Komuniteteve RAE të kthyer nga diaspora në sistemin e Arsimit në Kosovë”. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin përfaqësues të institucioneve, mësimdhënës, drejtorë shkollash dhe përfaqësues të këtyre komuniteteve. Aktiviteti i dytë ishte debati i zhvilluar në Radion “Roma Avazo”. Në këtë emision u debatua për punën një vjeçare të projektit dhe rezultatet e arritura në këtë projekt. Raporti për donatorin është përgatitur e po ashtu edhe raportet e monitorimit të implementimit të kësaj Strategjie i janë dorëzuar MASHT-it.

## **KOSOVISION Contest**

■ Ka filluar faza e dytë e këtij projekti. Të gjitha përgatitjet për implementimin e kësaj faze janë bërë në përputhje me projektin. Aktiviteti i parë i cili u zhvillua për këtë fazë ishte trajnimi i stafit lokal për ndihmën që duhet të ju japin mësimdhënësve të klasave fituese për realizimin e projektit. Po ashtu u mbajtën edhe dy punëtori me mësimdhënësit e klasave fituese. Punëtorja e parë përfshinte mësimdhënësit e Rajonit të Prishtinës, Gjilanit, Ferizajt dhe Mitrovicës. Ndërsa punëtorja e dytë përfshinte mësimdhënësit e Rajonit të Gjakovës, Prizrenit dhe Pejës. Në këto punëtori mësimdhënësit morën udhëzimet e para për implementimin e projekteve. Për të pasur qasje më të mirë dhe sukses në realizimin e këtyre projekteve, planifikohet edhe një punëtori tjetër me këta mësimdhënës gjatë muajit shkurt të këtij viti.

## Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Ky projekt filloi së implementuari në janar të vitit 2009. Projekti do të zgjasë 30 muaj dhe implementohet nga Qendra për Arsim e Kosovës në partneritet me Shoqatën Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës (KAHCR). Projekti financohet nga Komisioni Evropian, (Instrumenti për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut, EIDHR), dhe zhvillohet në rajonin i Prishtinës dhe të Prizrenit.

Përfitues drejtpërdrejtë të projektit janë nxënësit, mësimmshënësit dhe prindërit e fëmijëve të cilët do të përfshihen në projekt, respektivisht 60 shkolla me të cilat do të punohet në të dy Rajonet.

**Objektiva e përgjithshme** e projektit është: *të kontribuohet në zhvillimin e demokracisë në Kosovë duke mobilizuar shoqërinë civile dhe palët tjera të interesit që të nxisin respektimin e të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit.*

**Objektiva specifike** e projektit është: *të rritet vetëdija për situatën e të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit në Kosovë, duke organizuar veprim të bashkërenduar monitorimi të shoqërisë civile në kooperim me autoritetet qendrore dhe lokale, si dhe duke krijuar kapacitetin e shkollave që të kontribuojnë në këtë përpjekje.*

**Rezultate e pritshme:** zhvillimi i një sistemi për monitorimin dhe raportimin e situatës së të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit dhe kapacitetet e përmirësuar të nxënësve për të identifikuar dhe adresuar shkeljen e të drejtave të fëmijës në sistemin e arsimit.

## Access Microscholarship Program

■ Janari ka qenë periudhe e pushimeve për dy grupet e Prishtinës të përfshira në programin për mësimin e gjuhës angleze Access Microscholarship Mësimi për këto dy grupe filloi më 29 respektivisht 30 janar.

■ Ndërsa sa i përket grupit në Prizren orari ka qenë më ndryshe. Në Prizren mësimi ka filluar me 6 janar dhe ka vazhduar deri më 15 janar. Prej 15 janarit deri më 19 shkurt grupi i Prizrenit është në pushim.

## Cilësia e arsimit në rajonin e Dukagjinit (AVSI-CESAL)

■ Gjatë muajit janar, pasi filloi mësimi në shkolla e rajonit të Dukagjinit, ka filluar edhe shpërndarja e pyetësorëve dhe plotësimi i tyre nga ana e mësimmshënësve dhe drejtorëve. Është planifikuar që kah mesi i muajit shkurt të fillohet me përpunimin e të dhënave.

Përgatiti: Petrit Tahiri